



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-083

Prishtinë, më 23 shkurt 2017, në orën 09:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 SHKURT 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Haxhi Shala dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Vazhdimi i seancës me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 9, 14 dhe 15 shkurt 2017,
3. Përgatitjet për seancën e re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 6 shkurt 2017

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 6 shkurt 2017.

2. Vazhdimi i seancës me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 9,14 dhe 15 shkurt 2017

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 9, 14 dhe 15 shkurt 2017, si dhe të disa pika të mbetura nga seancat plenare të mëparshme, vendosi që Kuvendi t'i vazhdojë punimet më 27 shkurt 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,*
2. *Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera,*
3. *Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve,*
4. *Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, (për miratimin e këtij projektligji kërkohen të paktën 61 vota "për", prej tyre 11 vota të komuniteteve që nuk janë shumicë) - amendamenti 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 81, paragrafi 1),*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,*

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-149 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë,
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh.a. dhe operatorit të sistemit, të transmisionit dhe tregut-KOSTT sh.a.,
8. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb,
9. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
10. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
11. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë,
12. Koha për pyetje parlamentare.

* * *

3. Përgatitjet për seancën e re plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare të re, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e re e Kuvendit të mbahet të enjten, më 2 mars 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,
5. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit nr. 05/L-146 i drejtësisë për të mitur,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-144 për noterinë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-136 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime,

13. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe Ligjin nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.*

* * *

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, i hartuar nga Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, i hartuar nga Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

2. Procedimi i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, i hartuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, i hartuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

3. Propozim - Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Propozim - Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2017 e shtyu për mbledhjen e radhës.

4. Propozimi i deputetit Shaip Muja për dalje nga kriza për demarkacionin

Kryesia u njoftua me shkresën e deputetit Shaip Muja, me anë të së cilës u është drejtuar deputetëve të Kuvendit lidhur me propozimin e disa hapave konkretë për dalje nga kriza lidhur me çështjen e demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi.

5. Kërkesa e deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputet tjerë nënshkrues, për debat parlamentar me temë “Moszbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës”

Kërkesa e lartshënuar u shty për mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit.

6. Kërkesa e deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevaire Izmaqi, të mbështetur edhe nga 8 deputet tjerë nënshkrues për debat parlamentar në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë

Kërkesa e lartshënuar u shty për mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit.

7. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit 7-anëtarësh nga Parlamenti Britanik, të cilët janë duke qëndruar në Kosovë, prej 12-18 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa për lejimin e mbulimit të shpenzimeve të delegacionit 7-anëtarësh nga Parlamenti Britanik, të cilët kanë qëndruar në Kosovë prej 12-18 shkurt 2017, sipas kërkesës së bashkangjitur, me nr. 05/3141/DO-1607, datë 9 shkurt 2017.

8. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Grupit të Miqësisë me Gjermaninë i Kuvendit të Kosovës: Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Blerta Deliu-Kodra, Slobodan Petroviq, Ismet Beqiri, Safete Hadërgjonaj dhe Rexhep Selimi u lejohet udhëtimi zyrtar në Gjermani, prej 28-31 mars 2017.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga Bundestagu Gjerman, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, si dhe mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

9. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të darkës së shtuar nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës më 29 janar 2017, në Bruksel

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa për lejimin e mbulimit të shpenzimeve lidhur me darkën e shtruar nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës, më 29 janar 2017, në Bruksel, në shumë prej 223,80€.

10. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të deputetit David Geerts, me rastin e pjesëmarrjes së tij në Samitin e kryetarëve të komisioneve parlamentare për punë të jashtme, që do të organizohet në Prishtinë, nga 19 - 22 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa për lejimin e mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit të deputetit David Geerts, nga Dhoma Përfaqësuese e Parlamentit të Belgjikës me rastin e pjesëmarrjes së tij në Samitin e kryetarëve të komisioneve parlamentare për punë të jashtme, e cila është mbajtur në Prishtinë nga 19 - 22 shkurt 2017, sipas kërkesës së bashkangjitur 05/3154/DO-1616, datë 14 shkurt 2017.

11. Njoftim lidhur me rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së lidhur me emërimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së lidhur me rekomandimin e tyre dërguar Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta dërgojë pa vonesë në Kuvend propozimin për emërimin e mbikëqyrësit kryesor shtetëror dhe 4 (katër) mbikëqyrësve shtetërorë të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5 . Pikat shtesë

1. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Bruksel, prej 7 - 10 mars 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtareve të Grupit të Grave Deputete: Blerta Deliu-Kodra, Lirije Kajtazi dhe Shukrije Bytyçi, si dhe nga stafi mbështetës, Arjeta Rexhepi, u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel, prej 7-10 mars 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për të lartshënuarat në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës me mundësi rimbursimi nga Parlamenti Evropian, si dhe mëditjet mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës.

2. Kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik për lejimin e udhëtimit në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës: Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Blerim Grainca, Rustem Berisha dhe Enver Hoti u lejohet udhëtimi në Shqipëri, prej 2-5 mars 2017.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi do të mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3. Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel, prej 19-21 mars 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë: Haxhi Shala, Nuredin Lushtaku dhe Melihate Tërmmkollli u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel, prej 19-21 mars 2017.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi do të mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës.

4. Kërkesa e Klubit të Alpinistëve për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa e Klubit të Alpinistëve për mbështetje financiare – mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale